

“ PËR NJË PRODHIM TË PASTËR DHE TË QËNDRUESHËM TË MANDARINAVE ”

Projekti “MandaGREEN” –
modeli shqiptar për bujqësi të pastër



MANDARINA SHQIPTARE, FRYT I NATYRËS

► Në fshatrat e Dimalit, fermerët shqiptarë po tregojnë se ndryshimi është i mundur: nga toka e lodhur me kimikate drejt prodhimit të gjallë, të pastër dhe me shije. MandaGREEN, nismë e mbështetur nga projekti GreenAL, udhëheq këtë transformim me shembuj konkretë dhe praktika që funksionojnë.

QËLLIMI

► Të ndihmojmë fermerët shqiptarë të kalojnë nga modeli kimik në modelin ekologjik e të qëndrueshëm, duke ruajtur jetën, tokën dhe shëndetin.

SFIDAT AKTUALE

- 62% e fermerëve nuk marrin këshillim teknik për përdorimin e pesticideve.
- Shumica i blejnë pa etiketë shqip dhe pa paralajmërime.
- Produktet BIO janë të pakta, ndërsa ato me pesticide dominojnë tregun.

ZGJIDHJA

► Fermerët e MandaGREEN tregojnë se kompostimi, ujitja me pika dhe përzierjet natyrore japin rezultate reale. Hudhra, vaji i niem-it, soda e bukës dhe uthulla e mollës mbrojnë bimët pa ndotur tokën. Toka ringjallet dhe prodhon fruta më të shijshme, më jetëgjata dhe më të kërkuara në treg.



PRAKTIKAT QË FUNKSIONOJNË

Praktika	Përfitim
Kompostimi i mbetjeve organike	Rikthen pjellorinë natyrore të tokës
Ujitja me pika	Kursen ujë dhe shmang lagështinë e tepërt
Mbjelljet shoqëruese	Largojnë dëmtuesit natyrshëm
Plehu i gjelbër	Përmirëson strukturën e tokës
Mossperkatja në erë/diell	Mbron shëndetin e fermerit

STANDARDI I MANDAGREEN

► “BIO” dhe “Global G.A.P.” janë rruga për në tregjet evropiane: asnjë pesticid sintetik, gjurmueshmëri dhe kujdes për mjedisin. Ato sigurojnë kontroll periodik dhe certifikim i garantuar.

MODELI I SUKSESIT NË DIMAL

► Në zonën Poshnje–Dimal, fermerët e përfshirë në MandaGREEN kanë arritur ulje të përdorimit të pesticideve, rritje të rendimentit dhe cilësisë së frutit (referuar edhe analizave të kryera nga AKU, në mënyrë rastësore) dhe bashkëpunim me bashkinë për promovim më të gjerë të produktit (Festa e Mandarinës).

ADVOKIMI LOKAL – ZËRI I FERMERËVE

► Grupi advokues MandaGREEN bashkon fermerë, institucione dhe qytetarë për subvencione për agrumet ekologjike, tregje lokale për produkte të pastra, trajnime mbi pesticide dhe plehra organike, si edhe fushata ndërgjegjësimi në shkolla e bashki.

REKOMANDIME KRYESORE

- **Për fermerët:**
- Lexoni çdo etiketë para përdorimit.
- Mos spërkatni në erë apo diell të fortë.
- Përdorni maskë dhe doreza.
- Bashkohuni për certifikim BIO.

► Për bashkitë:

- Grumbulloni ambalazhet bosh (mbetjet).
- Krijoni qendra kompostimi.
- Promovoni tregjet lokale BIO.
- Për institucionet:
- Kontrolloni tregtimin e pesticideve.
- Subvenciononi inputet organike.
- Zbatoni strategjitë kombëtare me projekte pilot.

MESAZHI ETIK

► Toka nuk është thjesht për t'u shfrytëzuar, por për t'u lulëzuar. Nëse e mbjell me helme, korr varfëri. Nëse e mbjell me dashuri, korr jetë e mirëqenie.



MandaGREEN mbështetet nga projekti GreenAL, i cili financohet nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (Sida) me fondet e Qeverisë Suedeze dhe zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me VIS Albania dhe COSV - Cooperazione per lo Sviluppo.